



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 70, Datë 10.03.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GSA” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 275/4 prot., datë 06.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., në datën 26.02.2026 ka paraqitur aplikimin për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe ka kryer pagesën që i korrespondon këtij aplikimi, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Në vlerësimin e aplikimit për licencim është marrë në konsideratë edhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria në datën 26.01.2026 dhe janë bërë vlerësimet përkatëse në lidhje me afatet respektive të dokumentacionit apo vërtetimeve.
- Në këto rrethana, në rast licencimi të shoqërisë, vlefshmëria e licencës do të fillojë me përfundimin e afatit të licencës aktuale, pra më datë 24.06.2026.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se nga ana e shoqërisë nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.1. Shoqëria duhet të depozitojë Shtojcën 1, të plotësuar në të gjithë zërat e saj, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit për njërin nga administratorët e saj, pasi rezulton të jetë depozituar jashtë afatit të përcaktuar nga neni 8, pika 3 e Rregullores, si dhe të depozitojë dëshminë e penalitetit për administratorin tjetër, që nuk rezulton të jetë depozituar në dosje.
- **gërma “d”**: Shoqëria duhet të depozitojë aktin e përfaqësimit për përfaqësuesin ligjor.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të saktësojë/korrigjojë sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë dhe të depozitojë dokumentacionin vërtetues që provon disponimin e mbështetjes financiare të nevojshme për ushtrimin e të paktën 1 (një) muaj të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të saktësojë sasinë e energjisë elektrike për tregtimin në planin e biznesit, në referencë dhe të dokumentacionit tjetër të këtij aplikim, si dhe të përcaktojë mënyrën financimit të veprimtarisë.

Për sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GSA” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI